

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8JH-1

P 33

MYSLIM PASHA

Mallakastraj

POEME



854-1

P33.

MYSLIM PASHA

MALLAKASTRA

P o e m ë

LIBRERIA E SHTETIT

LIBRERIA E SHTETIT

67007

36214

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

NË VEND TË PARATHËNIES

Atëherë unë isha vetëm pesë vjeç. Nën rrapat e moçëm të Poçemit bëhej festë. Babai më ngrinte mbi supe dhe unë, duke prekur degët e rrapave, dëgjoja si fliste shoku Enver në tribunë. Kujtohej besëlidhja e korrikut të 1943-shit në Poçem.

... Kaluan vite dhe unë u rrita, por ai mëngjes korriku nuk do të përsëritet më. I ndjej ato brohorima të largëta sa herë marr rrugën e dashur mes gurëve të bardhë prej Kremenarit në Poçem.

Në atë përvjetor lindi dhe kënga:

I

Më thirrën brigjet me makje të gjelbëra,
ku çeturi me dhallë
qëndron në buzët e zhuritura të stinës,
ku nën krisma e marshime
brodhën dikur baballarët,
grisur nga teli i opingës.

Më thirrën pranë kërrabës së bushit,
pranë varrezave të dëshmorëve
ku skuqin flamujt;
pranë shkollarëve që varen mëhallave,
pranë dyfekëve, korijeve, arave...

Më thirrën një ditë brigjet
me makje të gjelbëra
veshur
në festën e çlirimit.
Unë ecja dorë për dore me

Myqerem Ademin...

duke malaksur vendlindjen
me qumështin e poemës nga vedër e dëllinjte...

II

... Nata rreth e rrotull psherëtin.
Nëpër gryka mullinjsh
nata ha mërzhitinë...
Dhe në qiellin e saj
fustanellë e Arianit Topisë
lëviz si diell.

III

Ecën Mallakastra,
ha hekur me dhëmbë.
Qëmton lakrat në murishte,
se balta rrit grurin e pakët
dhe nënat thërrasin të ngjethura:
«Oh, ç'u mbarove, farmak!»

Mbas lotve në rrugë e djerrina,
kala e Gradishtës përtypte legjenda
dhe u thërriste pranverave të vinin.

Vinte pranvera.
Po vinte dhe hasmi.
Ikte një armik
dhe vinte një tjetër.
Mes grykave,
nën armët e nxehta,
shtegtonin karvanet e gjymtuara.

Dhe duart e grisura, të rjepura,
duke bredhur në brazat e ugareve
duhej të hapnin burime,
ku të lagnim buzën e tharë,
larg yrteve të shtruara të agallarëve.
Pastaj me gunën e dhirtë
shtegtoje mbi vuajtjet e grindjet...

Ku do të shkoje kështu?
Në cilën rrugë priste Rrapo Hekali?
Në cilin kuvend thërriste Gjoleka?
Portave të tua nga jugu në veri
tytat e pushkëve të nxehta.

Dhe dera e Rrapos ka ngelur çelë.
Në odën e tij të lashtë si në saksi
bisqet e këngës janë mbjellë...

Fryjnë erërat e Gradishtës
mbi krahët e turtujve, pëllumbave.
Krahët e turtujve dhe pëllumbave,
mbi kufomat e treqind burrave.

Kapedan Rrapo!
Ç'janë ata zinxhirë?
Dhembja e ngarkuar mbi brigjet
vjen pas.
Greshica u skuq.
Fluturuan pëllumbat
nëpër ditët e murrme të fukarasë...

Dritaret e horizontit grinden.
Nometë e çobanëve nëpër dridhje.
Jatagani i Rrapos
shkëlqen nën degët e ullinjve.

— Hej! Mallakastër e sipërme,
që vrave goxha Isuf be,
ç'dashke vënë në batare! —
çirret pashai qimezi
nën një qiell me re...

Dhe shamitë e zeza të nënave
lëkunden prapa zinxhirëve

si retë e dimrit të ashpër.
U lagin ballin

nipërve...

Parmendat na ngrinë në duar,
parmendat me dru hilqe punuar.
Blerimet vështronin nëpër pranvera
dhe ne përherë të menduar.

Duhej të rridhte djersë,
si ujërat e Mullirit të Kashtës
që të gatuanim një harapash të shkretës,
që të radhisnim në kamare fishekët...

Ç'është kështu?

Si je pleksur, moj botë terse?
Thërmojmë plisat e vakët në lehë
sikur të gjenim rrënjët e jetës...

Dhe Xhemal Aranitasi
hante nga varfëria jonë qejfet,
kur fshatarët e sertë
numëronin vdekjet...

Se na i blenë arat agallarët,
po s'na e blenë jetën.
Në krahë hodhëm trastën e dhirtë
e u nisëm!
në të përpjetat e fatit të shkretë...

Ku t'ia kërkonim rrënjët botës?
Sa herë udhëve do t'u binim kryq e tërthor?
Sa herë do të përfyteshim me spiunë e sejmënë
që të shihnim qiellin e Mallakastrës sonë?

Ik e kthehu sërish,
si zogjtë që kërkojnë foletë mes blirit.
Fëmijët që lindëm,
grisur nga përrallet,
i rritnin puthjet tona të ngrohta
dhe kafshata e misërt...

IV

Kur na i shpoi brinjët
me gjilpërën e helmatisur?
Gjymtyrët i lëvizëm në buzë të Margëlliçit,
ku çadrat e teknikëve të huaj
u ngritën mbi dhenë e vidhisur.

Dritaret e tokës nëpër gjurma hapeshin,
dhe sytë e botës shikonin.
Piketatat priteshin
dhe instrumentët trasonin udhën e maqinave,
duke prerë shpirtin e krahinës...

Dhe prisnim fatin e bardhë,
si në përrallat e vjetra,
të na e sillte kjo rrugë,
që e hapte botorja.
Ku e dinim se mbreti kodosh
bënte pazare...
dhe hapësirat shqiptare përdorte si lodra.
Shpirt, që na dhemb shumë!
Ç'është kjo?
Udhë maqinash apo gjarpër,
që na kafshon brinjët?
Inxhinierët fashistë, duke parë projektet,
mendnin për ushtritë e Musolinit.

Kështu përditë
rrudhat na thelloheshin nga mendimi
e bëheshin lugina.
Gjyshet tona i hante meraku
se mos na prishej bukuria.